



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës NR. 06/L-092, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10 e datës 3 prill 2019 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes bën këtë:

**FTESË PUBLIKE**  
**PËR DËRGIMIN E PROPOZIMEVE PËR ANËTARË TË KOMISIONIT VLERËSUES**  
**NGA SHOQËRIA CIVILE (VAZHDIM I AFATIT PËR APLIKIM)**

Njoftohen përfaqësuesit e Organizatave Joqeveritare - Shoqërisë civile të cilat veprojnë dhe kanë selinë në territorin e Komunës së Lipjanit se është vazhduar afati për aplikim për dërgimin e propozimeve për anëtarësim në Komisionin vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës përkitazi me Propozim-Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme — lokaleve afariste në ZK Lipjan dhe ZK Magurë, i cili propozim- vendim pritet të miratohet në seancën e radhës të Kuvendit të Komunës

Numri kërkuar : 1 (një) anëtarë nga Shoqëria civile.

Propozimet sipas mundësisë duhet të përfshijë personat me prioritet nga lëmi i shkencave juridike, ekonomike, bujqësore apo të ndonjë lëmie tjetër të pregaditjes superiore.

Propozimet tuaja do të jenë të mirëpritura dhe duhet ti drejtohen Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe të njëjtat të dorëzohen në ndërtesën e Komunës kati përdhësë në Qendrën për shërbime për qytetarë më së largu me datë 26.02.2025 .

Ftesa të publikohet në Webfaqen e Komunës .

1Nr.020/04-7064/2  
Më datë: 21.02.2025



KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti